



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER VALBONA SH. SELIMI
ADRESA Rr.'Hoxha Tahsim', Godina
nr.292, Kati i I-re, Tirane
TEL: 695761243

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 191

Nr. koleksioni: 100

Tirane më 11/01/2024



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2024052730010945567

RECEIVED
JUL 16 1964
LIBRARY





A2024052730010945567

MARRËVESHJE PËR BLERJEN E KUOTAVE

(ne vijim referuar "Marreveshja")

Sot, me dt 11.01.2024, para meje noteres Valbona Selimi, anetare e Dhomes Kombetare te Notereve, Dega Tirane, ne zyrën time me seli ne Rrugen Hoxha Tahsim, nr. 292, u paraqiten personalisht palet e meposhtme:

- **Znj. Xhenis Angjeli**, atësia Arben, amësia Miranda, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në TIRANË, me adresë Nikolla Tupe; Nd. 44; H. 2; Ap. 8; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 25/05/1995, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Letërnjoftim ID nr. 039087572 dhe nr. personal J55525072W,
- **Z. Eros Angjeli**, atësia Anastas, amësia Greta, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Nikolla Tupe; Nd. 44; H. 2; Ap. 8; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 06/03/1991, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 037990627 dhe nr. personal J10306061H

më tej referuar sebashku si " Shitesi ",

dhe

- Shoqeria **A Capital Holding** shpk, me NUIS M32405032B, me administrator **Z. Eros Angjeli**, atësia Anastas, amësia Greta, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Nikolla Tupe; Nd. 44; H. 2; Ap. 8; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 06/03/1991, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Letërnjoftim ID nr. 037990627 dhe nr. personal J10306061H, me tej referuar si "Bleresi".

HYRJE

- A. Nga data 18.09.2023, **Znj. Xhenis Angjeli** eshte ortake e vetme e shoqërisë "HPG Energy" sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me Numër Unik Identifikimi (NUIS) **L81603016R**, e organizuar në bazë të ligjeve shqiptare, me adresë ne TIRANE Njesia Administrative Nr.5, Rruga Nikolla Tupe, Pallati 1, Ap.9, Kodi Postar 1019, (më tej referuar si "**Shoqëria**"), ndersa **Z. Eros Angjeli eshte bashkeshort i Znj. Xhenis Angjeli**.
- B. Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësit dhe Shitësit dëshirojnë t'i shesin Blerësit, kuoten që Shitesit zoterojnë;
- C. Per sa me siper, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Marrëveshje, me qëllim përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të angazhimit të tyre respektiv për shitjen dhe blerjen e kuotave.

PALET BIET DAKORD SA VIJON:

1. PËRKUFIZIME DHE INTERPRETIME

1.1 Përkufizime

Termat me shkronja te medha shtypi ne kete Marreveshjeje do te kene kuptimin e percaktuar ne vijim:



A2024052730010945567

"Barrë" nënkupton cdo pretendim, interes apo e drejte e cdo individi (duke përfshirë cdo të drejtë për të blere, mundesi për të blere në të ardhmen apo të drejtë parablerjeje) ose cdo hipoteke, kolateral, peng, cedim, kufizim, interes sigurues (duke përfshirë edhe ato të krijuar me ligj), ruajtje të drejte ose cdo marrëveshje sigurimi apo marrëveshje ose rregullim tjetër barresues apo marrëveshje qeraje, qeraje financiare, shitje me kredi apo marrëveshje tjetër për pagim me rezerve;

"Qendra Kombëtare e Biznesit" nënkupton organin publik Shqiptar që ka kompetencën regjistrimit në regjistrin tregtar të Shqipërisë.

2. TRANSFERIMI I KUOTAVE

2.1 Shitja e Kuotave

Në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje Shitësit shesin duke kaluar në pronësi të plotë të Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësit përqindjet si me poshte të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë:

(i) Blerësi blen nga Shitësit një kuotë që përfaqëson 100 % të kapitalit të Shoqërisë.

Si rrjedhojë e kësaj shitje Blerësi zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Transferimi i kuotave bëhet në përputhje me këtë Marrëveshje dhe të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi.

Titulli i pronësisë mbi kuotat transferohet tek Blerësi në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshjeje. Kuotat shitet së bashku me të gjitha të drejtat dhe përfitimet që lidhen me to ose që u jepen atyre deri në datën e kalimit të pronësisë mbi kuotën (duke përfshirë të drejtën për të marrë gjithë dividendin, shpërndarjen ose ndonjë kthim të kapitalit të deklaruar, të paguar ose të realizuar nga Shoqëria deri në sot), të lira dhe të parënduara me ndonjë Barre.

2.2 Cmimi i Blerjes

Blerësi i paguan Shitësve për blerjen si me sipër shumën totale prej 10.000 Euro.

2.3 Pagesa e Çmimit të Blerjes

Palet deklarohen se bien dakort që pagesa e cmimit të blerjes do të shlyhet me transferte bankare në llogarinë e Shitëses Xhenis Angjeli.

2.4 Vendimi i Ortakut

Blerësi deklaron se e miraton këtë blerje kuotash dhe se këtë miratim e reflektojnë në vendimin e ortakut të tij që vendos mbi miratimin e transferimit të Kuotes nga Shitësit tek Blerësi.

3. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

3.1 Marrëveshja dhe Amendamentet

Kjo Marrëveshje zhvleftëson cdo marrëveshje të mëparshme ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshjeje. Cdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje është i vlefshëm vetëm nëse është bërë me shkrim dhe është nënshkruar prej ose në emër të secilës prej Palëve dhe i referohet në mënyrë specifike kësaj Marrëveshjeje.

3.2 Transferimi

Kjo Marrëveshje do të jetë e detyrueshme për zbatim dhe do të zbatohet edhe prej pasardhësve të Palëve por nuk do të jetë e transferueshme pa miratimin paraprak me shkrim të Palëve të tjera.



3.3 Regjistrimi i Marreveshjes

Pas shpjegimit palëve se regjistrimi i kësaj kontrate duhet bere brenda 30 ditesh, Palet bien dakort se regjistrimi i Marreveshjes ne Qendren Kombëtare te Biznesit do te behet nga Bleresi brenda nje afati 15 ditor.

LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

Kjo marrëveshje rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet shqiptare, e veçanërisht me nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe nenit 705 e vijues te Kodit Civil. Palët bien dakort që cdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë, interpretimin apo zbatimin e Marrëveshjes të zgjidhet nëpërmjet Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

* * *

Kjo marrëveshje e mësipërme, lexohet nga unë noteri për palët, dhe palët pasi deklaruan se e kuptojne ate dhe e kanë gjetur marrëveshjen në përputhje me vullnetin e tyre të lirë, e nënshkruajnë rregullisht më poshtë dhe unë noteri e vërtetoj sipas ligjit. Unë, Noteri, verifikova identitetin e palëve në bazë të dokumenteve të identitetit dhe pasi konstatova përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm në përputhje me nenet 62, 63 dhe nenet vijuese të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetojnë nënshkrimet e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noteri deklaroj se do të mbroj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe ligjore. Pulla takse në vlerën 700 lekë është aplikuar në kopjen e kontratës që mbaj unë, Noteri, në arkivin tim noterial. Ekstraktet tregtare të paleve, kerkimet RBS, dhe kartat e identitetit të nënshkruesve i janë bashkangjitur kësaj kontrate.

Palet

Xhenis Angjeli

Shoqeria A Capital Holding shpk

Administratori Eros Angjeli

Xhenis Angjeli

Eros Angjeli

Eros Angjeli

Eros Angjeli

Noter Valbona Selimi

Valbona Selimi